



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1239/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar te kolegjit, sipas padisë së paditësit NOTAbrillant Official SH.P.K., me seli në rrugën “Marije Shllaku” nr.75, Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.R., kundër të paditurit NOTAbrillant Design & Style SH.P.K., me seli në rrugën “Medllin Ollbrajt” nr.34, Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.K. dhe K.N.Sh. avokate nga Prishtina, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.2038.2022 të datës 05.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e autorizuarit të paditësit NOTAbrillant official SH.P.K., me seli në rrugën “Marije Shllaku” nr.75, Gjilan.

II.VËRTETOHET Aktgjykimit i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.2038.2022 i datës 05.06.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar KE.nr.2038.2022 të datës 05.06.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit NOTAbrillant official SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet shkelja e markës tregtare të regjistruar sipas numrit 17343, të datës 26.06.2013, nga ana e të paditurit NOTAbrillant Design & Style SH.P.K., dhe të urdhërohet i padituri që në të ardhmen të përmbahet nga shkelja e mëtutjeshme e markave të paditësit, të obligohet që të ndërpresë vendosjen e mëtutjeshme në qarkullim të lirë të markës tregtare NOTA dhe emrit tregtar NOTAbrillant, të obligohet të ndryshojë emrin e biznesit dhe të largojë të gjitha materialet promovuese që posedon në emër të markës dhe emrit tregtar NOTA, si dhe të detyrohet i padituri që në emër të dëmtimit të imazhit dhe të kompensimit të dëmit material dhe jo-material, të ia kompensojë paditësit shumën prej 900,000.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,470.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i aktgjykimit me kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II të dispozitivit ka detyruar paditësin që të paditurit, t’ia kompensoj shpenzimet e

procedurës kontestimore në shumën prej 540.80 € (pesëqind e katërdhjetë euro e tetëdhjetë cent), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa, të ndryshohet aktgjykimi i goditur dhe të aprovet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe të anulohet vendimi i goditur si i pabazuar ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditurit, duke e kundërshtuar ankesën e paditësit, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi, pranë gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar padi kundër së paditurit për shkak të shkeljes së markës tregtare, duke kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të miratohet si e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar KE.nr.2038/2022 të datës 05.06.2023, me të cilin ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar duke iu referuar kriterëve themelore për vlerësimin e ngjashmërisë së shenjave në fjalë: shkalla e ngjashmërisë vizuale (në pamje), shkalla e ngjashmërisë aurale (në dëgjim), si dhe shkalla e ngjashmërisë konceptuale dhe pas vlerësimit të provave të administruara, foto dokumentacionit në shkresat e lëndës ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në tërësi, pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me lloje të njëjta të markave tregtare. Gjykata tutje ka arsyetuar se ndërmjet markës tregtare verbale të paditësit dhe shenjave të përdorura nga i paditurit ekzistojnë dallime të mëdha, pasi që marka e paditësit përbëhet vetëm nga fjala “NOTA” ndërsa i padituri përdor shenjen “NOTA Brillant Design & Style”, ku shkronjat janë me ngjyrë të bardhë, ndërsa prapavija është me ngjyrë të kuqe si dhe shkronjat “b” dhe “a” janë të stilizuara. Gjykata ka arsyetuar po ashtu se duke marrë parasysh faktin se paditësi e ka të regjistruar markën e tij tregtare “NOTA”, si markë verbale, ndërsa markat tregtare verbale (Markat Fjalë) gëzojnë mbrojtje juridike të kufizuar, gjykata vlerëson se tek këto marka tregtare paditësi mund ta kontestojë përdorimin e kësaj shenje, vetëm në rastet e të ashtuquajturit “identiteti i dyfishtë” midis markës së mëhershme

të regjistruar dhe markës së shkelësit. Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka vlerësuar se mbrojtja e markës fjalë si në rastin konkret, mund të kërkohej vetëm nëse të njëjtat janë identike, përkatësisht të dy markat janë marka fjalë dhe kanë saktësisht të njëjtën varg të shkronjave apo numrave. Mirëpo nëse njëra markë është markë fjalë, ndërsa tjetra është markë figurative apo e stilizuar, atëherë nuk mund të ekzistoj identiteti i markave, meqenëse një markë fjalë dhe një markë figurative nuk mund të konsiderohen identike.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se duke marrë parasysh se qëllimi kryesor i markës tregtare është që të shërbejë si identifikues i burimit të produktit dhe se marka duhet të ketë veçori dalluese, si dhe duke u nisur nga kriteri i rëndësishëm i vlerësimit të shkeljes së markës tregtare, të ashtuquajturit “spektri i dallueshmërisë”, ka vlerësuar se shenja e përdorur nga i padituri ka dallime të dukshme nga marka fjalë e regjistruar e paditësit, me çka rezulton se marka fjalë e paditësit nuk është cenuar nga i padituri, dhe si rrjedhojë e kësaj kërkesëpadia e paditësit, për vërtetimin e shkeljes së markës tregtare nga ana e të paditurës, dhe kompensimin e dëmit material dhe jo material, nuk ka mbështetje ligjore, andaj gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit.

Gjykata vendimi e ka bazuar në nenin 8 të Ligjit për Marka Tregtare dhe nenin 452.1 të LPK-së për shpenzimet e procedurës.

Kolegji i Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë i vlerëson të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit lidhur me shkeljen e markës tregtare për arsye se gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së mallrave dhe shërbimeve, gjykata duhet ta ketë parasysh: natyrën e mallrave dhe të shërbimeve, perceptimin e konsumatorit mesatar dhe faktin nëse këto dy ndërmarrje janë në konkurrencë me njëra tjetrën, por për vlerësimin e shkallës së ngjashmërisë në mes të markave duhet merren parasysh: shkalla e ngjashmërisë vizuale (në pamje), shkalla e ngjashmërisë aurale (në dëgjim), si dhe shkalla e ngjashmërisë konceptuale.

Nga fotot që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se ndërmjet markës tregtare verbale të paditësit dhe shenjave të përdorura nga i padituri ekzistojnë dallime të mëdha, pasi që marka e paditësit përbëhet vetëm nga fjala “NOTA”, ndërsa i padituri përdor shenjën “NOTA Brillant Design&Style”, ku shkronjat janë me ngjyrë të bardhë, ndërsa prapavija është me ngjyrë të kuqe, fondi i shkronjave nuk është i njëjtë. I padituri edhe pse ka përdorur ngjyrën e kuqe dhe të bardhë, megjithatë nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërehet se ndërmjet markës tregtare të

paditësit dhe shenjës së përdorur në objektin e të paditurit ka elemente dalluese ndërsa ngjashmëria ndërmjet tyre konsiston në përdorimin e ngjyrave kuqë dhe bardhë të cilat gjenden tek të dyja objektet mirëpo, dizajni, fondi i shkronjave dhe fjala dallojnë, sepse produkti i të paditurit përmban shqiptime të ndryshme, nuk është i njëjtë me produktin e paditësit andaj e bëjnë të dallueshme nga konsumatori me vëmendje/kujdes të rëndomtë dhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit në këtë element është e pamundur. Prandaj kjo gjykatë vlerëson se përdorimi i ngjyrave të ngjashme në produktin e të paditurit, në shqiptimin e ndryshëm dhe me kombinime tjera nuk shkelin markën tregtare të paditësit.

Gjithashtu kolegji vlerëson se për vlerësimin e ngjashmërisë dhe dallimet e markës tregtare kontestuese duhet krahasuar të gjitha elementet e markës tregtare: dukjen, shqiptimin dhe kuptimin e markës tregtare dhe me rastin e shqyrtimit të ngjashmërisë vlerësimi nuk mund të reduktohet në konstatimin e pjesshëm të ngjashmërisë të vetëm njërit prej elementeve të theksuara por duhet të bëhet vlerësim i përgjithshëm i të gjitha ngjashmërive dhe dallimeve të markës tregtare si tërësi. Për vlerësimin e ngjashmërive duhet të vlerësohet se markat tregtare a është e ngjashme në të gjitha nivelet përkatëse të krahasimit me shenjen tregtare.

Neni 8 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të LMT-së, kërkon ekzistimin e identitetit midis (1) markave/shenjave në diskutim dhe (2) mallrave apo shërbimeve në fjalë. Ky nen, nuk imponon provimin e mundësisë së shkaktimit të konfuzionit tek konsumatori relevant, midis markës së mëhershme dhe markës për të cilën pretendohet se shkel markën e mëparshme. Në rastin konkret të gjitha elementet e cekura dallojnë. Lidhur me pretendimet e paditësit se aktgjykimi i atakuar është bazuar në nenin 8 të Ligjit për Marka Tregtare i cili ligj është shfuqizuar e ligjin e ri për Marka tregtare 08/L-075. Këto pretendime janë të pabazuara pasi këto dispozita ligjore ishin në fuqi në kohën kur është parashtruar padia me dt. 27.04.2022, ndërsa Ligji i ri për Marka tregtare nr. 08/L-075 ka hyrë në fuqi në Korrik të viti 2022.

Për vlerësimin e drejtë të kësaj çështje, kjo gjykatë vlerësoi edhe “nivele të dijenisë së publikut për markën ose të njohjes së saj në sektorin publik përkatës” si një prej kriterëve themelore të përcaktuara me “Rekomandimet e Përbashkëta” të miratuara nga Kuvendi i Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Kuvendi i Përgjithshëm të Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale (OBPI), lidhur me vlerësimin e shkeljes së markave tregtare. Në rastin konkret logoja – shenja identifikuese të cilën e përdorë paditësi për veprimtarin e tij nuk është e njëjtë me të paditurin, e të cilat kanë dallime të dukshme, andaj edhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit tek këta konsumator është shumë e vogël sepse të njëjtit me vëmendje të rëndomtë do ta dallonin emrin e paditësit dhe të paditurës, për shkak se këto dyja kanë shenja të mjaftueshme dalluese ndërmjet tyre.

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Markat Tregtare, për vlerësimin e ngjashmërisë së markave duhet krahasuar të gjitha elementet e markës tregtare: dukjen, shqiptimin dhe kuptimin e markës tregtare dhe me rastin e shqyrtimit të ngjashmërisë vlerësimi nuk mund të reduktohet në konstatimin e pjesshëm të ngjashmërisë të vetëm njërit prej elementeve të theksuara por duhet të bëhet vlerësim

i përgjithshëm i të gjitha ngjashmërive dhe dallimeve të markës tregtare si tërësi. Në rastin konkret edhe pse kemi të bëjmë me aktivitete të njëjtë biznesore, marka tregtare e regjistruar e paditësit dhe marka e përdorur e të paditurit kanë dallime në pamje, në kuptim, si dhe në konceptin e tërësishëm të paraqitjes së shenjave në dizajnin grafik.

Marka Tregtare përbën një shenjë e cila përshkruan një produkt dhe bartë informacione tek konsumatori lidhur me prejardhjen e atij produkti. Funkzioni kryesor i markës tregtare është të shërbejë si identifikues burimi. Në rastin konkret emri i të paditurit nuk përmban elemente të cilat kanë për qëllim që konsumatorin ta vënë në lajthim lidhur me shërbimet dhe të krijojnë përshtypjen se është fjala për te njëjtin biznes, por përmban elemente dalluese të qarta nga të cilat lehtë mund të identifikohen.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë.

Nga sa u parashtrua e në mbështetje të dispozitës së nenit 200 të LPK është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1239/2023, me datë 08.02.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi